

lindasi



e librit, theksoi se besa si institucion, sublimon të gjitha vetitë pozitive të moralit shqiptar. Ai citoi një shkrimtar francez i cili në shkrimet e tij cek se "feja e shqiptarëve është besa". Besa dhe kanuni i Lekë Dukagjinit, shprehet akademik Krasniqi, kanë qenë së bashku ligje të përmbledhura për nevojat e atëhershme që kanë pasur rolin e rregullimit të jetës fisnore, zakonore dhe tradicionale në trojet shqiptare.

Mark Krasniqi ishte nxitësi dhe organizatori kryesor i ngritjes së monumentit të Skënderbeut në Prishtinë më 28 nëntor 2001. Në fjalën e mbajtur me këtë rast, presidenti Rugova ka thënë: "I nderuari profesor Krasniqi, ju falemnderit për angazhimin tuaj, që në Prishtinë e ngritët këtë monument, e kryet edhe një punë që i ka hije profesorit. Falënderoj edhe udhëheqjen komunale të kryeqytetit, që përkrahu angazhimin e profesor Krasniqi dhe të gjithë ata që kontribuan, pra TMK-ja, pastaj të tjerët që i përsëndeti profesor Krasniqi që e sollën monumentin, apo shtatoren e Skënderbeut në Pishinë, që e kemi këtu para nesh."

Akademik Mark Krasniqi, si një bashkëpunëtor besnik dhe krah i djathtë i Presidentit Rugova, jo vetëm i qëndroi pranë por edhe e mbështeti prijësin historik të shqiptarëve të Kosovës, në momentet më delikate të historisë dhe lëvizjes për liri, pavarësi e demokraci, nën emblemen e LDK-së

Mark Krasniqi jeton dhe vepron në Prishtinë. ■

Shkëputur

A

Ata që kanë pasur fatin e madh ta njohin nga afër, u mbetet gjatë në kujtesë prezencja e tij elegante, e folura e rrjedhshme, veshja tërheqëse dhe paraqitja e një babaxhani, ndonëse tashmë i ka kaluar të nëntëdhjetat.



B

Profesori, akademiku, shkrimtari, studiues dhe poeti Mark Krasniqi u lind më 19 tetor 1920 në fshatin Gllavicë (Shëngjon) afër Pejës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, kurse më 1941 gjimnazin në Prizren. Prej vitit 1941-1943 ka studiuar letërsinë në Universitetin e Padovaës në Itali, e prej 1946-1950 ka studiuar gjeografinë e etnografinë në Universitetin e Beogradit.

C

Mark Krasniqi ishte nxitësi dhe organizatori kryesor i ngritjes së monumentit të Skënderbeut në Prishtinë më 28 nëntor 2001. Në fjalën e mbajtur me këtë rast, presidenti Rugova ka thënë: "I nderuari profesor Krasniqi, ju falemnderit për angazhimin tuaj, që në Prishtinë e ngritët këtë monument, e kryet edhe një punë që i ka hije profesorit.



Bota Sot ONLINE
Klikoni: www.botasot.us

Ndër arbëreshët e Italisë

"RES ALBANICAE" – Revistë shkencore e re

Revista është semestrale dhe botohet nga Fondacioni universitar "Francesco Solano" i Universitetit të Kalabrisë. Kryeredaktor prof. Metteo Mandalà, arbëresh nga Hora e Arbëreshëve (Siçili)

Labinot Berisha

Revista shkencore "Res Albanicae", numri i parë i së cilës doli kohë më parë, është organ i Fondacionit universitar "Francesco Solano", i cili u themelua në Universitetin e Kalabrisë më 2008. Francesco Solano ishte një prift dhe profesor arbëresh nga Frasnita e Kalabrisë, i cili më 1975 themeloi Katedrën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Universitetit të Kalabrisë dhe e udhëhoqi deri më 1990. Solano ishte edhe vetë themelues i revistës "Vija", organ i "Rrethit" arbëresh, e cila, për shkaqe të mungesës së mjeteve materiale, doli vetëm një numër. Prof. Solano botoi një varg veprash të rëndësishme nga fusha e letërsisë dhe e gjuhësisë. Po përmend këtu vetëm "Manuale di lingua albanese" (Doracak i gjuhës shqipe), që përjetoi disa botime. Veprat letrare autori i botoi me pseudonimin Dushko Vetmo. Veprën me poezi, "Bubuqe t'egra", me të cilën fillon poezia bashkëkohore e arbëreshëve të Italisë, e botoi më 1946 në Buenos Aires të Argjentinës ku qëndroi rreth gjysmë shekulli. Themelimi i Fondacionit dhe themelimi i revistës "Res Albanicae" lidhen me personalitetin dhe me kontributin e këtij intelektual të shquar në botën e arbëreshëve dhe në fushën e studimeve albanologjike. Para së të paraqes përmban etjen e numrit të parë të revistës "Res Albanicae", po përmend faktin se pikërisht tek arbëreshët e Kalabrisë u themelua më 1848 gazeta e parë "L'Albanese d'Italia" (Shqiptari i Italisë) nga Jeronim De Rada si dhe revista e parë zëmadhe "Fjamuri i Arberit" (1883 - 1887), themeluar po ashtu nga De Rada. Më vonë doli gazeta "La nazione albanese" (Kombi shqiptar) botuar në vitet 1897 - 1924



RES ALBANICAE

ISSN 2279-7173

RES ALBANICAE

Rivista di albanologia

anno I, n. 1, marzo 2012



Fondacioni Universitar - Fondazione Universitaria
"Francesco Solano"

nga Anselmo Lorecchio. Brenda kësaj tradite të pasur e të gjatë të botimit të revistave ndër arbëreshët e Italisë duhet përmendur dhe revistën "Zjarri" (Il fuoco), themeluar më 1969 dhe udhëhequr deri më 1998 nga prifti arbëresh, Zef Farrako (Gieseppe Farraco). Numrit të parë të revistës "Res Albanicae" i prin fjala e rastit e prof. Françesk Altimarit, drejtor i Dipartimentit të gjuhësisë të Universitetit të Kalabrisë dhe drejtues i Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të këtij Universiteti. Në të thuhet se qëllimin i botimit të revistë është të nxisë studimet dhe hulumtimet në fushën e albanologjisë në një hapësirë gjeografike të gjerë, duke udhëzuar përparësi sidomos studiuesve të rinj për të mundësuar ndriçimin e trashëgimisë arbëreshë dhe gjithëshqiptare, por edhe kërkimet më të reja rreth bashkë ekzistimit të kulturave e të ndikimit të tyre. Në 267 faqet e numrit të parë janë botuar

dhjetë kontribute të rëndësishme nga fusha të ndryshme të albanologjisë në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze. Punimeve u prin ai i F. Altimarit me titull "Mbi huazimet nga italishtja dhe nga dialektet italo-romane në sistemin foljor të arbërishtes së Kalabrisë", pastaj ai në anglisht: 'Case' categories in the Geg Albanian variety of Shkodër" (Kategoritë 'rasore' në të folmen e Shkodrës) i autorëve M. R. Manzini dhe L. M. Savoia. Në vijim botohen punimet e A. Omarit, M. Mandalà, B. Demiraj, S. Corso, A. Aliu, M. G. Giacomarra, F. Macchianò dhe punimi i përbashkët i autorëve A. Piro, G. Tagarelli, A. Tagarelli. Duke u mbështetur në rëndësinë dhe llojshmërinë e punimeve të numrit të parë mund të thuhet se revista "Res Albanicae" do të jetë një tribunë e hapur që do të sjellë rezultate në fushën e studimit të albanologjisë dhe më gjerë.

Realizimi grafik i revistës është bërë nga Shpend Bengu. ■